


KUSHTETUTA JU MBRON

KUSHTETUTA JU MBRON

- Të Drejtat dhe Liritë Themelore
- Dinjiteti i Njeriut
- Zbatimi i Drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare
- Barazia para Ligjit
- E Drejta e Integritetit Personal
- E Drejta e Martesës dhe Familjes
- Ndalimi i Torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues
- Mbrojtja e Pronës
- Bashkëjetesa Martesore
- Barazia Gjinore dhe të Drejtat Civile
- E Drejta për Arsim
- E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit
- Puna
- Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale
- Familja

Kjo fletushkë Ju njofton me të drejtat tuaja si qytetare e Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Kushtetutë. Fletushka nuk mund të zëvendësohet për këshilla juridike.





KUSHTETUTA JU MBRON

“Dhuna ndaj grave është shkelja më e turpshme e të drejtave të njeriut. Me gjasë është edhe më e përhapura. Nuk njeh kufij gjeografik, kulturorë, apo të mirëqenies. Dhe derisa vazhdon nuk mund të pohojmë që jemi duke bërë një progres të vërtetë në drejtim të barazisë gjinore, zhvillimit dhe paqes”!

(Mars 1999, Kofi Anan, Sekretarë i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara)*



Neni 21. Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Raport mbi Dhunën në Familje

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), pran zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka ndërmarrë iniciativën për realizimin e Hulumtimit mbi Dhunën në Familje. Kjo iniciativë është mbështetur nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PZHKB- UNDP) si pjesë e Sigurisë së Grave dhe e Iniciativës së Sigurisë (SGIS), si dhe është realizuar nga Rrjetin e Grave të Kosovës (RRGK), në korrik të vitit 2008.

**Kontakttoni RRGK
mund t'iu informojnë më shumë
038 245 850**

*Sipas Kodit Penal dhe Rregullores mbi Dhunën në Familje ofrohet një përkufizim i veprimeve, ose të mungesës së veprimeve të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare si bazë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes në një procedurë gjyqësore civile.

1. Shkaktimi i lëndimit trupor;
2. Aktet seksuale pa pajtim ose shfrytëzimi seksual;
3. Shkaktimi i frikës te personi tjetër lidhur me mirëqenien e tij ose të saj fizike, emocionale ose ekonomike;
4. Kidnapimi;
5. Shkaktimi i dëmit në pronë;
6. Kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit tjetër;
7. Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;
8. Largimi i dhunshëm i personit tjetër nga vendbanimi i përbashkët;
9. Ndalimi i personit tjetër nga hyrja ose lëshimi i vendbanimit të përbashkët ose
10. Angazhimi në një model të sjelljes me qëllim të degradimit të personit tjetër.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

“Ligji Ju Mbron”

Neni 23. Dinjiteti i Njeriut

Ju jeni qenie njerëzore, andaj ju keni dinjitet dhe dinjiteti juaj duhet të mbrohet. Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

91.1 % e kryerësve të dhunës në familje kanë qenë meshkuj, kryesisht burra, dhe vetëm 8.9% kanë qenë gra.

(Sipas SHPK-së, në Raportin e ABGJ-së mbi dhunën në familje)

**Kontaktoni SHPK-në;
Njësitë për dhunën në familje
112 ose 92**

Përafërsisht, 43% të intervistuarve kanë deklaruar se kanë përjetuar dhunë familjare gjatë jetës së tyre; ndër ta 46% femra dhe 39.6% meshkuj.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

Grupi Joformal i Grave Parlamentare,

“Dhuna në familje është shqetësim i çdonjërit. Ekzistojnë ligje dhe konventa ndërkombëtare, të cilat i përkrahin të drejtat tona kushtetuese”:

Neni 22.

Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Dhuna në familje kundër grave e shkakton vdekjen dhe invaliditetin në mesin e femrave të moshave prej 16 deri 44 në një shkallë më të lartë se sa lufta, kanceri ose aksidentet Automobilistike në botë.

(Sipas Këshillit të Evropës, në Raportin e ABGJ-së mbi dhunën në familje)

Neni 24. Barazia para Ligjit

Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të ju trajtoj më pak se të tjerët, për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendje ekonomike apo sociale, orientim seksual, lindje, aftësi të kufizuar apo ndonjë statusi tjetër personal.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

"Të gjithë
janë të
barabartë"



11.8% e grave dhe 5.7% e burrave kanë thënë se mbi ta është ushtruar trysni që të kenë më shumë fëmijë se sa ata kanë dashur. Para së gjithash, është ushtruar trysni mbi gratë nga partnerët e tyre ose vjehrrit e tyre për të pasur më shumë fëmijë, derisa mbi meshkujt është ushtruar trysni nga prindërit e tyre dhe ndonjëherë nga partnerët e tyre.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

**"Është trupi juaj
Të drejtat e tua vendimi YT"**

**Neni 26.
E Drejta e Integritetit Personal**

Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të saj, që përfshin:

- të drejtën të vendos nëse ajo dëshiron të ketë fëmijë.
- të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj.
- të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit saj në pajtim me ligjin;
- të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

**Neni 37.
E Drejta e Martesës dhe Familjes**

Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)



82.1 % të intervistuarve janë pajtuar se, “nëse fqinjët e kuptojnë se në një familje ka pasur dhunë të brendshme, do ta konsideronin atë si Turp.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

Dhuna kundër femrës është e formave të ndryshme, nga ato të dukshmet deri tek ato më deliketet. Organizata për shëndetit e gruas (WHO) adaptuar definicionet e poshtëshënuara të dhunës fizike dhe seksuale, për të ndihmuar në hulumtim dhe programim, duke u koncentruar në veprimet e identifikuar;

Dhuna Fizike

nënkupton kur një grua është: goditur me shuplak; është shtyer; apo i janë shkukur flokët; e goditur me grusht, apo me diçka tjetër me të cilën shkakton dhimbje; e ngulfatur apo djegur; e kërcënuar me armë;

Dhuna Seksuale

nënkupton kur një grua është; detyruar fizikisht të ketë marrëdhënie seksuale; ka pasur marrëdhënie sepse ka qenë e frikësuar se çka mund të bëjë partneri i saj; apo është detyruar të bëjë diçka seksuale, të cilën e ka konsideruar degraduese dhe poshtëruese; Ndonëse i njohur si problem serioz dhe mjaft i përhapur,

Dhuna Emocionale

ende nuk ka ndonjë definicion plotësisht të pranueshëm, por, përfshin për shembull; të qenurit e poshtëruar apo e nënçmuar; të qenurit e frikësuar qëllimisht.

Dhuna brenda partnereve

(po ashtu e quajtur dhunë “familjare”) nënkupton, kur gruaja u ka nënshtruar njëres nga llojit të dhunës së lartpërmendur, nga duart e partnerit apo ish-partnerit intim; kjo është njëherit forma më e zakonshme dhe universale e dhunës që përjetojnë femrat.

(Raport i WHO; “Adresimi i dhunës kundër femrave dhe arritja e objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit”; Departamenti i Gjinisë, Gruas, Shëndetit Familjar dhe Komunitetit)

“JO do të thotë JO”

Neni 27.

[Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues]

Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

“Ndal Dhunën”

Femrat posedojnë më pak se 10 % të pasurisë dhe të paluajtshmërive në Kosovë krahasuar me meshkujt që posedojnë 90 %. Më tej, gratë kanë poseduar aq pak sa është barazi me 2 deri në 6.2 % të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

(Sipas Ombudspersonit, në Raportin e ABGJ-së mbi dhunën në familje)

Disa gra nganjëherë frikësohen ta ndërpresin një lidhje të dhunshme martesore, sepse ato mendojnë se nuk posedojnë asgjë, apo nuk mund t'ia dalin mban vet.

Kënd mund ta kontaktoj për këshilla juridike?

Kontakto Zyrën koordinuese për ndihmë Juridike në:

Prishtinë: +381(0)38 20018 224

Prizren: 044 646 289

Gjilan: 044 646 291

Pejë: 044 646 287

Mitrovicë: 044 646 279

Kontakto Ombudspersonin për më shumë informata
038 501 401

Neni 46. Mbrojtja e Pronës

E drejta e pronës është e garantuar. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Neni 42. Bashkëjetesa Martesore

Bashkëshortet janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore.

(Ligji i familjes)

Neni 16.6. Barazia Gjinore dhe të Drejtat Civile

Pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë regjistrohet në regjistrat publik si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve.

(Ligji për Barazi Gjinore)

Neni 16.10. Barazia Gjinore dhe të Drejtat Civile

Në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve, pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.

(Ligji për Barazi Gjinore)

**Neni 47.
E Drejta për Arsimin**

Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.


(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Femrat në Kosovë kanë për 3 herë shkallën më të madhe të analfabetizmit se sa meshkujt.

Vajzat janë të prirura të lëshojnë shkollën midis arsimimit fillor mandator dhe atij të mesëm, shumë më shumë se sa meshkujt.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

**“Kurrë s'është vonë për arsimim,
njeriu arsimohet gjatë gjithë jetës!”**



Më shumë se 40 % e grave nuk kanë punuar për arsye se ato është dashur të kujdesen për fëmijët ose shtëpinë, krahasuar me vetëm 5.8 % të burrave.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

Neni 49.
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve

E drejta e punës garantohet. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Neni 13.9.
Puna

Punëdhënësit marrin masa të nevojshme për t'u mundësuar femrave dhe meshkujve të përshtatin detyrimet e tyre profesionale dhe familjare. Organizimi i punës dhe orarit, në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe gjendjen familjare të të punësuarve, bëhet në mënyrë që të siguroj kthimin në vendin e njëjtë të punës pas pushimit të lindjes, pushimit prindëror, pushimit të abortit, pushimit mjekësor ose pas kohës së kaluar jashtë vendit të punës për shkaqe urgjente familjare, apo aftësime profesionale.

(Ligji për Barazi Gjinore)

Dhuna mund të ndikojë në shkaktimin e dhembjes akute dhe kronike, në shkaktimin e sëmundjeve të : lukthit, zorrëve, veshkave, muskujve, në ngritjen e tensionit të gjakut. Ndikon negativisht në shtatzënësi dhe në gjendjen e përgjithshme psikologjike.

(ABGJ, Raport mbi dhunën në familje)

"Dhuna Familjare, ka pasoja shëndetësore afatgjata"

Neni 51. Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)

Neni 2. Familja

"Familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje".

(Ligji i Familjes)

Ne, gratë deputete punojmë në emër të të gjitha grave, në përmirësimin e qasjes për shërbime më të mira shëndetësore, duke përfshirë edhe këshillimet për dhunën në Familje.

(Grupi Joformal i Grave Parlamentare, Parlamenti i Republikës së Kosovës)

Mekanizmat Institucional për Barazi Gjinore

Kuvendi i Republikës së Kosovës

- Grupi Joformal i Grave Parlamentare -
- Komisioni Parlamentarë për Liri dhe të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të pa gjetur dhe Peticione

Qeveria e Republikës së Kosovës

- Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës
- Institucioni i Ombudspersonit- Njësia për Barazi Gjinore
- Zyrtaret/ët për barazi gjinore në Ministri
- Këshilli Ndër-Ministror për Barazi Gjinore
- Sektori për çështje gjinore-MAPL

Mekanizmat ne Nivelin Lokal

- Zyrtarët/et për barazi gjinore në komuna
- Komitetet komunale për barazi gjinore

Mekanizmat Jo-Qeveritare

- Organizatat jo-qeveritare
- Strehimoret (në gjashtë qytete)

Mekanizmat Qeveritar që trajtojnë Dhunën në Familje

- Njësi i Dhunës në Familje- Shërbimi Policor i Kosovës
- Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave-Ministria e Drejtësisë
- Prokuroritë dhe Gjykatat
- Qendrat për Punë Sociale - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Grupi Parlamentar i Grave është i përkushtuar të përfaqësoj dhe të jetë zëri i të gjitha grave në të gjitha Institucionet e Kosovës. Grupi parlamentar është i bashkuar për ndërtimin e shtetit demokratik të Kosovës i cili siguron pjesëmarrjen e gruas në të gjitha sferat e shoqërisë dhe të vendim-marrjes.

“Nuk mund të imagjinohet një Shtet Demokratik pa Gruan dhe pjesëmarrjen aktive të saj, në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe politike.”

Grupi Joformal i Grave Parlamentare Parlamenti i Republikës së Kosovës

NDI, dëshiron të falënderoj Grupin Joformal të Grave Parlamentare, në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Agjencinë për Barazi Gjinore, pranë zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për bashkëpunim të ngushtë në përpilimin e kësaj fletushke.



Grupi Joformal i Grave Parlamentare,
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Neformalna Grupa Ženskih Poslanika
Skupština Republike Kosovo

Informal Group of Women Parliamentarians
Assembly of Republic of Kosovo



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / KABINET PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNU RAVNOPRAVNOST
AGENCY OF GENDER EQUALITY